

# STATUTI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “AUTO CITY TIRANA ”

Në Tiranë, sot me datën 02.05.2019 (dy mijë nëntëmbëdhjetë) ne te nenshkruarit, **Tauland Kamberi**, i biri i Nexhatit, i datëlindjes 15/04/1987, lindur ne Peshkopi, dhe banues ne Tirane, Rr. Albion Tershalla, me Numer Identifikimi Personal **I70415005E**, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e ortakut themelues, dhe **Julian Muja**, i biri i Muharremit, i datëlindjes 08/07/1984, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Loni Ligori me Numer Identifikimi Personal **I40708093W**, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e ortakut themelues, si dhe **Ergesti Mulla**, i biri i Muaremit, i datëlindjes 07/07/1989, lindur ne Korce, dhe banues ne Tirane, Rr. Xhanfize Keko, me Numer Identifikimi Personal **I90707076J**, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e ortakut themelues, themeluam shoqërinë tregtare AUTO CITY TIRANA dhe vendosem unanimitisht të miratojme këtë Statut për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “AUTO CITY TIRANA” në përputhje me Ligjin №. 9901, datë, 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave që vijojnë:

### Neni 1 ORTAKU

1.1 Themelues dhe ortakë të Shoqërisë janë:

- **TAULAND KAMBERI** me gjeneralitetet si më sipër;
- **JULIAN MUJA** me gjeneralitetet si më sipër;
- **ERGESTI MULLA** me gjeneralitetet si më sipër.

### Neni 2 LLOJI I SHOQËRISË

2.1 Shoqëria e krijuar është e llojit:-Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

### Neni 3 EMËRTIMI DHE SELIA

3.1 Emërtimi i shoqërisë është: AUTO CITY TIRANA – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që në mjaft raste, në dokumentet e krijimit të saj, do të shkruhet edhe shkurt: “Shoqëria”

3.2 Shoqëria ka të drejtën e ndryshimit të emrit dhe të përgjegjësisë, duke bërë regjistrimet përkatëse në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3.3 Selia e Shoqërisë është: Tirane, Kashar, Rruga Butrinti, Ambient i hapur me Nr.Pasurie 1180/1, ZK.2105.

3.4 Kontaktet të tjera vullnetare janë: Telefon: 0699509999, Email: auto.city@hotmail.com

3.5 Shoqëria do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Nenin 22 e në vijim të Ligjit №.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3.6 Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik qysh nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3.7 Shoqëria përgjigjet me të gjitha aktivet e saj për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.

3.8 Shoqëria është themeluar më datën, 02.05.2019 (dy mijë nëntëmbëdhjetë)

#### **Neni 4 KOHËZGJATJA**

4.1 Shoqëria do të funksionojë për një periudhë kohe të papërcaktuar.

#### **Neni 5 OBJEKTI DHE QËLLIMI I VEPRIMTARISË**

##### **Neni 5/1 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

5.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Sherbim parkimi dhe karrotreci. Import-Eksport dhe Shit-Blerje me pakice të automjeteve të llojeve të ndryshme. Agjensi për dhenie me qera të automjeteve të perdorura. Agjensi komisionere dhe ndermjetesimi për shitjen e automjeteve të perdorura të treta.

##### **Neni 5/2 QËLLIMI I VEPRIMTARISË**

4.1 Shoqëria krijohet me qëllim që ne, themeluesit e saj të merremi me ushtrimin e veprimtarisë së lirë private dhe, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të përfitojmë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, që pasqyrohet në Nenin 5.1 të këtij Akti.

4.2 Shoqëria mund të krijojë adresa sekondare si filiale, degë, zyra përfaqesimi, dyqane dhe çdo organ tjetër të lejuar nga dispozitat ligjore në fuqi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 6 KAPITALI I SHOQËRISË**

6.1 Fillimisht, Kapitali themeltar i Shoqërisë është:

**Kapitali në para:** 100.000 (Njëqindmijë) lekë, i barabartë me 3 (Tre) kuota, i depozituar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me pjesemarrje të:

- Tauland Kamberi, 1(nje) kuote, me kontribut ne para ne masen 34,000(Tridhjete e kater mije)Lek, qe perfaqeson 34(Tridhjete e kater)% të kapitalit, i barabartë me 34(Tridhjete e kater) të drejta vote;
- Julian Muja, 1(nje) kuote, me kontribut ne para ne masen 33,000(Tridhjete e tremije)Lek, qe perfaqeson 33(Tridhjete e tre)% të kapitalit, i barabartë me 33 (Tridhjete e tre) të drejta vote;
- Ergesti Mulla, 1(nje) kuote, me kontribut ne para ne masen 33,000(Tridhjete e tremije)Lek, qe perfaqeson 33(Tridhjete e tre)% të kapitalit, i barabartë me 33 (Tridhjete e tre) të drejta vote;

**Kapitali në natyrë:** - Krahas ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, si dhe të mundësive ekonomiko – financiare që do t'i krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyrë

(pasuri të luajshme apo të paluajshme ose në të drejta të vlerësueshme në para), siç do të vendosë në të ardhmen Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë do të rritet ose do të zvogëlohet në përputhje me ecurinë e veprimtarisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marrë në të ardhmën Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

6.3 Kuotat e nënshkruara me kontribut në para mund të shlyhen edhe pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6.4 Pjesët e kapitalit themeltar, personave të tretë (domethënë jashtë shoqërisë), u kalojnë vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

#### Neni 7

#### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

7.1 Në përputhje me kushtet dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe të vendimeve që do të marrin organet përkatëse të saj, shoqëria mund ta zmadhojë ose ta zvogëlojë kapitalin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

7.2 Si zmadhimi, ashtu edhe zvogëlimi i kapitalit, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kudo gjetkë që të jetë e nevojshme, si dhe publikohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe ato të këtij statuti.

#### Neni 8

#### THEMELIMI I SHOQËRISË

8.1 Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**AUTO CITY TIRANA**”, pas miratimit të Kontratës (Aktit të themelimit) dhe Statutit nga themeluesit e saj, quhet e krijuar në përputhje me dispozitat e Ligjit №.9901, datë, 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

8.2 Shoqëria regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me dispozitat e Ligji Nr.131/2015 Per Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Ligjit №. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

8.3 Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria mund të krijojë një faqe të saj në internet. Të dhënat, të cilat regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, do të publikohen në këtë faqe për t’u vënë në dispozicion të personave të interesuar.

#### Neni 9

#### REGJIMI JURIDIK

9.1 Në të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet nga legjislacioni në fuqi dhe, veçanërisht nga dispozitat e Ligjit №.9901, datë, 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, si dhe nga amendamentet përkatëse ligjore që mund t’i bëhen këtij ligji në të ardhmen.

9.2 Për çdo çështje që nuk trajtohet në këtë legjislacion dhe realizohet në territorin e Republikës e Shqipërisë, zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, praktikat tregëtare, si dhe praktikat lokale ose të veçanta, të cilat marrin përparësi ndaj praktikave të përgjithshme.

9.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, regjimi juridik i Shoqërisë mund të ndryshojë në qoftë se në të ardhmën krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Në këtë rast, ortaket e Shoqërisë, do ta përshtasin si Aktin e Themelimit (Kontratën), ashtu edhe Statutin e Shoqërisë, si dhe do të bëjnë depozitimet përkatëse si në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ashtu edhe në dokumentet që mbahen në selinë e saj.

9.4 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të Ligjit “Mbi investimet e huaja”, si dhe të marrëveshjeve të bëra gjer

më sot dhe të atyre që do të bëhen në të ardhmen midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

9.5 Shoqëria mund të marrë përsipër detyrime, si dhe e padisë dhe të paditet përpara organeve kompetente gjyqësore, si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ashtu edhe në gjykatat e vendeve të tjera ku do ta ushtrojë veprimtarinë e saj të lirë private.

9.6 Në marrëdhëniet juridike me persona të tretë, Shoqëria del në emër dhe llogari të vetë.

9.7 **Administrator dhe përfaqesues ligjor i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët janë te 3 ortaket themelues te shoqerise:**

➤ **Tauland Kamberi;**

➤ **Julian Muja;**

➤ **Ergesti Mulla;**

**Ku veprimet e administrimit/perfaqesimit te secilit prej tyre jane te vlefshme edhe me firmen/nenshkrimin e vetem njerit prej tyre si administrator/perfaqesues ligjor.**

9.8 Administratori dhe përfaqesuesi ligjor i Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe prej **5 (pese) vjetësh**, duke filluar qysh nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 10**

#### **PËRGJEGJËSIA E THEMELUESVE**

10.1 Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik, përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për veprimet e kryera në emër dhe për llogari të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

10.2 Themeluesit dhe personat me të cilët ata veprojnë për krijimin e Shoqërisë japin kontributin përkatës në shoqëri, siç kanë vendosur. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

#### **Neni 11**

#### **DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT**

11.1 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë në vende të ndryshme.

11.2 Degët kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

11.3 Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të shoqërisë, sipas të drejtave dhe kompetencave të dhëna nga organet drejtuese të saj.

#### **Neni 12**

#### **TË DHËNAT NË KORRESPONDENCAT DHE DOKUMENTET E TJERA TË VEPRIMTARISË.**

12.1 Të gjitha shkresat, formularët e urdhërave apo çdo dokument tjetër korrespondence, të nxjerra nga shoqëria, nga degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: Numrin unik të identifikimit; formën ligjore të shoqërisë; vënd-ndodhjen e selisë së regjistruar dhe atë të zyrës qendrore të saj, si dhe të dhëna të tjera të detyrueshme ligj në qoftë se shoqëria është në "likuidim" apo "falimentim".

12.2 Me krijimin e faqes në internet, këto të dhëna duhet të pasqyrohen edhe aty.

12.3 Shoqëria përgjigjet për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara.

12.4 Shoqëra do të përfaqësohet sipas rregullave të përcaktuara nga Ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga dispozitat e këtij Statutit, si dhe nga dispozitat e tjera ligjore në fuqi. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

### Neni 13

#### E DREJTA E INFORMIMIT

13.1 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët themeluesë për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e secilit prej tyre, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre që përbëjnë sekret sipas nenit 18 të Ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Neni 14

#### ABUZIMI ME DETYRËN DHE FORMËN E SHOQËRISË

14.1 Ortakët e shoqërisë, administratori, si dhe çdo anëtar tjetër i saj, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi, në qoftë se:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar shoqërinë, që në vartësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të realizuar detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

### Neni 15

#### NDALIMI I KONKURENCËS

15.1 Përfaqësuesit ligjorë të Shoqërisë, administratori(ët) dhe anëtarët e organeve të drejtimit të shoqërisë nuk mund të mbajnë një funksion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

### NENI 16

#### RUAJTJA E SEKRETIT

16.1 Çdo person tjetër që merr dijeni për të dhëna me karakter sekret për shoqërinë, është i detyruar që të mos e nxjerrë tek të tretët.

16.2 Përveç dispozitave ligjore në fuqi për nocionin e "sekretit", Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë apo sipas rastit administratori dhe përfaqësuesi ligjor në marrëdhënie me të tretët e përcakton edhe vet llojin e të dhënave dhe të informatave që konsiderohen sekrete për shoqërinë.

### Neni 17

#### MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

17.1 Kuotat e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të

shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit, si dhe të çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

17.2 Kuotat dhe të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen nga askush, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të kuotave, që mban shoqëria, në përputhje me dispozitat ligjore.

17.3 Shoqëria mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të kuotave të shoqërisë, si: emri e mbiemri i ortakut, vlera nominale e kuotës, adresa e banimit, data e kryerjes së regjistrimit, si dhe çdo e dhënë tjetër e domsdoshme.

17.4 Administratori(ët) është (janë) përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të kuotave. Informacioni i regjistrit të kuotave duhet të publikohet në faqen e internetit të shoqërisë. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin on-line të të dhënave, që duhen regjistruar sipas ligjit.

#### **NENI 18**

##### **VAZHDIMI I SHOQËRISË NGA TRASHËGIMTARËT**

18.1 Në rast vdekjeje të ortakut (ortakëve), kuotat e kapitalit që ai ka (zotëron) në Shoqëri u kalojnë trashëgimtarëve ligjorë të tij, respektivisht sipas legjislacionit në fuqi. Këto kuota, trashëgimtarët ligjorë mund t'i mbajnë për vete ose mund t'ua kalojnë personave të tretë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Fillimisht, kuotat i ofrohen ortakëve të shoqërisë dhe në rast se asnjëri prej tyre nuk u përgjigjet pozitivisht, atëherë mund t'u jepen personave të tretë edhe jashtë Shoqërisë.

18.2 Trashëgimtarët mund të ushtrojnë të drejtën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data, në të cilën Noteri përkatës, sipas dispozitave ligjore në fuqi, lëshon dëshminë e trashëgimisë.

#### **NENI 19**

##### **KOSTOT E THEMELIMIT**

19.1 Themeluesit mund t'i kërkojnë shoqërisë rimbursimin e kostove të themelimit, deri në vlerën më të lartë.

19.2 Kostot e themelimit i paguhen themeluesëve nga fitimet, që realizon shoqëria ose siç do të vendosin vet themeluesit e Shoqërisë.

#### **NENI 20**

##### **TË DREJTAT E VOTËS**

20.1 Pjesëmarrja në kuotën e kapitalit në shoqëri, është në përputhje me % e pjesëmarrjes në te.

20.2 Sot me date 02.05.2019 zotëruesi:

- Tauland Kamberi, ka në masen e 34(Tridhjetë e kater) e të drejta vote;
- Julian Muja, ka në masen e 33(Tridhjetë e tre) e të drejta vote;
- Ergesti Mulla, ka në masen e 33(Tridhjetë e tre) e të drejta vote;

#### **NENI 21**

##### **NDALIMI I FALJES SË DETYRIMIT MBI KONTRIBUTET**

21.1 Shoqëria nuk mund t'i falë detyrimin për të shlyer kontributet në para apo kalimin e kontributeve në natyrë të nënshkuara nga ortakët, si dhe detyrimet e tjera, që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimit për shlyerje apo kalim të kontributit.

21.2 Ortakët nuk mund të kompensojnë të drejtat, që mund të kenë ndaj shoqërisë me detyrimin për shlyerjen apo kalimin e kontributit të nënshkuar, si dhe nuk mund t'i japin shoqërisë një kontribut të rënduar me barrë.

## NENI 22

### NDALIMI I KTHIMIT TË KONTRIBUTEVE

22.1 Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, kontributet nuk mund t'u kthehen ortakëve.

## NENI 23

### REZERVA LIGJORE DHE REZERVAT E TJERA

23.1 Nga fitimi pas tatimit të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 (pesë) për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 (dhjetë) për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, në rast se kjo siç do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë në ardhmen.

23.2 Shoqëria llogarit dhe ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikën 1 (një) të këtij neni.

## NENI 24

### DEKLARIMI I DIVIDENDIT

24.1 Dividendi është pjesa që i takon secilit ortak nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga Asambleja e përgjithshme.

24.2 Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji №. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

24.3 Dividendi shpërndahet midis ortakëve, në raport me vlerën e kapitalit themeltar të regjistruar nga secili prej tyre dhe pjesëmarrjes se tyre në kapital.

## NENI 25

### RIKTHIMI I PAGESAVE TË PALIGJSHME

25.1 Ortakët detyrohen t'i kthejnë shoqërisë të gjitha shumat e përfituara nga ajo në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të këtij Statuti.

## NENI 26

### ORGANET E DREJTIMIT TË SHOQËRISË

- a) Asambleja e përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë;
- b) Administratorët dhe përfaqësuesi(t) ligjor(ë) të shoqërisë.

## NENI 27

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË.

27.1 Asambleja e përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë i Shoqërisë dhe përbëhet nga themeluesit e saj, si dhe nga ortakët që mund t'i shtohen asaj në të ardhmen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

27.2 Ajo është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

27.3 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

27.4 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

27.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

## NENI 28

### MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

28.1 Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga Ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nga ligjet e tjera ose nga dispozitat e Statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

28.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori(ët) apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 83 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

28.3 Asambleja e përgjithshme thirret në qoftë se, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.

28.4 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

28.5 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

28.6 Në rastet e parashikuara në pikat 28.3 dhe 28.5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

28.7 Dispozitat e pikës 28.6 të këtij neni nuk zbatohen në qoftë se blerjet, sipas pikave 28.4 dhe 28.5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

28.8 Në rastet e parashikuara në pikat 28.3 deri në 28.5 të këtij neni, Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## NENI 29

### MËNYRA E THIRRJES

29.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

29.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 29.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsitë.

### NENI 30

#### KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

30.1 Në përputhje me pikën 1 të Nenit 83 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë mund ta kërkojnë edhe ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të votave apo një pjesë më të vogël të parashikuar në Statut.

30.2 Në qoftë se, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e përgjithshme nuk thirret ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

30.3 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 31.1 dhe 30.2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

30.4 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjera të ndryshme nga ata të ortakut të përfaqësuar.

### NENI 31

#### PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

31.1 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

31.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e përgjithshme.

31.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### NENI 32

#### KUORUMI

32.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Nenit 87 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, duke votuar sipas pikës 3 të Nenit 88 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

32.2 Në qoftë se asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 32.1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

### NENI 33

#### MARRJA E VENDIMEVE

33.1 Si rregull i përgjithshëm, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

33.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në Statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

33.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në Statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### NENI 34

#### E DREJTA E VOTËS

34.1 Ortakët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, të drejtën e votës, mund ta ushtrojnë edhe nëpërmjet mundësisë së pjesëmarrjes me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

34.2 Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vend-ndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

34.3 Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

34.4 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo Statuti i shoqërisë, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

### NENI 35

#### PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

35.1 Ortaku **nuk** mund të ushtrojë të drejtën e votës në qoftë se Asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

37.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i cili vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, si edhe vet ortaku që ai përfaqëson.

## NENI 36

### PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

36.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori(ët) përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

36.2 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

36.3 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

36.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

36.5 Porsa Shoqëria të publikojë një faqe në internet, administratori(ët), jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## NENI 37

### HETIMET E POSAÇME

37.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës (objektit të veprimtarisë).

37.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël (siç mund të parashikohet në Statut) dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës (objektit të veprimtarisë), kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të Statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Në qoftë se asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

37.3 Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 37.2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

37.4 Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 37.2 dhe 37.3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

37.5 E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 37.1 dhe 37.2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 (tre) vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

37.6 Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 37.2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

### NENI 38

#### SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TË PARREGULLTA DHE DËMSPËRBLIMI

38.1 Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit(ëve), kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të Statutit.

38.2 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të votave në Asambleshë e shoqërisë ose një vlerë më të vogël të parashikuar në Statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë, mund t'i kërkojnë Asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas refuzimit nga Asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Në qoftë se Asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

38.3 Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga Asambleja e përgjithshme.

38.4 Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" zbatohet edhe për këto padi.

### NENI 39

#### TË DREJTAT E LIDHURA ME KUOTËN

39.1 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së kapitalit në shoqëri, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 (tre) vjetëve nga çasti i cënimit.

### NENI 40

#### NDALIMI I KUFIZIMEVE

40.1 Janë të pavlefshme dispozitat që mund të vendosen në Statutin e shoqërisë, të cilat kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.

40.2 Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të çenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### NENI 41

#### ADMINISTRATORËT

#### EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

41.1 Për drejtimin e përditshëm të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të saj. Afati i emërimit, i cili caktohet në Statut, nuk mund të jetë më i gjatë se **5 (pese) vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Me gjithë atë, Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

41.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

41.3 Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të përtëditshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

41.4 Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, administratorët janë të detyruar të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.

41.5 Në qoftë se asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Por, Statuti ose rregulloret e miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë edhe ndryshe.

41.6 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë votash të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo ta kufizojnë këtë të drejtë. Padië, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## NENI 42 PËRFAQËSIMI

42.1 Kufizimet e të drejtave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

42.2 Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

42.3 Të drejtat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## NENI 43 SHPËRBLIMI

43.1 Shpërblimit bazë të administratorëve mund t’i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje e ndonje fitimi tjetër. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

43.2 Shpërblimi, sipas pikës 43.1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

43.3 Në qoftë se shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

43.4 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

#### NENI 44

##### DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

44.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë me mirëbesim dhe në interes të shoqërisë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në Statut;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

44.2 Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim.

44.3 Në qoftë se administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 44.1 dhe 44.2 të këtij Neni, janë të detyruar t’i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojnë çdo fitim personal që vjen nga këto veprime të parregullta.

44.4 Në mënyrë të veçantë, administratorët janë të detyruar t’i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

44.5 Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 (tre) vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

#### NENI 45

##### PRISHJA E SHOQËRISË SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

45.1 Shoqëria do të priset në këto raste:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) në qoftë se nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit №.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera të përligjura.

## NENI 46

### REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES

46.1 Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të Ligjit №. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në qoftë se prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit №.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

## NENI 47

### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE LARGIMI I ORTAKUT PËR SHKAQE TË ARSYESHME

47.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria në qoftë se ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, në qoftë se është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, në qoftë se shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

47.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

47.3 Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 47.2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t’i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

47.4 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, në qoftë se pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njuh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

47.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, në qoftë se rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

47.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

## NENI 48

### PËRJASHTIMI I ORTAKUT

48.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t’i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, në qoftë se ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të Statutit ose në qoftë se ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

48.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 48.1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel Statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

48.3 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e ylerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

48.4 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

48.5 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, në qoftë se kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

#### **NENI 49**

##### **PASOJAT E LARGIMIT DHE PËRJASHTIMIT**

49.1 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

49.2 Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

#### **NENI 50**

##### **LIKUIDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE**

50.1 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të Ligji t "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **NENI 51**

##### **RREGULLORJA**

51.1 Për mbarëvajtjen e veprimtarisë drejtuese të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme duhet të marrë masa që të bëjë rregulloren e Shoqërisë. Vendimi për miratimin e rregullores merret në mënyrë unanime.

#### **NENI 52**

##### **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

52.1 Kontrolli i veprimtarisë së Shoqërisë ushtrohet nga një ose disa ekspertë të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe që misionin e tyre e kryejnë në përputhje me ligjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 53**

##### **EMËRIMI I LIKUIDUESVE**

53.1 Likuidimi i shoqërisë kryhet nga një ose disa likuiduesë të emëruar nga asambleja e përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

53.2 Në rastet kur shoqëria prishet me vendim gjykate likuidusin ose të likuiduesit i emëron Gjykata.

#### **NENI 54**

##### **REGJISTRIMI PRANË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT**

54.1 Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

54.2 Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ndiqet nga shënimi "në likuidim".

#### **NENI 55**

##### **ADMINISTRIMI NGA LIKUIDUESIT**

55.1 Likuiduesi ose likuiduesit marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit.

55.2 Në se shoqëria emëron më shumë se një likuidues, ata i ushtrojnë bashkërisht të drejtat dhe detyrimet. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

55.3 Likuiduesit u nënshtrohen mbikëqyrjes së ortakëve, asamblesë së përgjithshme dhe organeve të tjera drejtuese që mund të krijojë shoqëria në të ardhmen.

#### **NENI 56**

#### **LLOGARIA BANKARE E SHOQËRISË**

56.1 Shoqëria hap llogari bankare si në Bankat Kombetare Shqiptare, ashtu edhe në banka të tjera shtetërore apo private brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në lekë apo valutë të huaj, siç do ta shohin të arësyeshme ortakët.

56.2 Shoqëria i mban llogaritë në lekë shqiptare ose në valutë të huaj sipas rastit që i paraqitet për veprime në vlera të ndryshme monetare.

56.3 Shpenzimet e shoqërisë në lekë apo në valutë të huaj, sigurohen nga arkëtimet e tregtimeve dhe shërbimeve të ndryshme që ajo kryen sipas objektit të saj të veprimtarisë ose nga mënyra të tjera që lejon legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **NENI 57**

#### **VITI EKONOMIK**

57.1 Viti ekonomik fillon më 01 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, kurse për vitin 2019, qysh nga fillimi i veprimtarisë së Shoqërisë dhe përfundon më 31 Dhjetor 2019.

#### **NENI 58**

#### **DHËNIA E LLOGARISË EKONOMIKE**

58.1 Shoqëria funksionon në bazë të dispozitave ligjore ekonomike në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të dispozitave të Aktit të Themelimit dhe Statutit të krijimit të saj, si dhe të programeve të veçanta që do të hartojë Asambleja e Përgjithshme e saj për çdo vit ekonomik.

58.2 Llogaria ekonomike e Shoqërisë mbështetet në llogaritë e shërbimeve dhe tregëtimeve të saj, si dhe të vetëfinancimeve që mbulon shpenzimet e veta, duke përfshirë ato në lekë dhe në valutë të huaj.

58.3 Për nxitjen ekonomike të veprimtarisë së Shoqërisë do të krijohen fonde rezervë dhe fonde të tjera të veçanta, sipas mundësive që i krijohen shoqërisë.

58.4 Mbatja e kontabilitetit të Shoqërisë do të bëhet sipas rregullave, metodave dhe teknikave kontabël, veprimeve që ajo kryen, si dhe të ngjarjeve që i ndodhin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare.

58.5 Kontabiliteti mbahet në gjuhën shqipe, në lekë shqiptare sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi, si dhe në valutë të huaj për çka do ta shohin të arësyeshme organet e drejtimit të Shoqërisë.

58.6 Për mbajtjen e kontabilitetit do të përdoret çdo regjistër i detyrueshëm që parashikohet nga dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

58.7 Forma e organizimit të kontabilitetit do të zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme të Shoqërisë, duke patur parasysh që ajo të sigurojë:

- regjistrim të hollësishëm dhe kronologjik të të gjitha veprimeve dhe ngjarjeve që trajtohen në kontabilitet;
- ruajtjen e të dhenave dhe disponimin e tyre në çdo kohë;
- përgatitjen e dokumenteve përmbledhëse të parashikuara ose të kërkuara;
- kontrollin e saktësisë së të dhënave.

58.8 Çdo formë organizimi të kontabilitetit që do të përdoret, do të jetë e tillë që të mundësojë kryerjen e kontrollit të jashtëm në mënyrë të tillë që, çdo ekspert të nxjerrë

nga librat kontabël, brenda një kohe të arsyeshme, një pamje të përgjithshme të veprimeve të kryera dhe te veprimtarisë së Shoqërisë.

58.9 Kontrolli i përgjithshëm dhe statistikor i shoqërisë bëhet mbi bazën e dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë dhe ato që do të përcaktojnë herë pas here Asambleja e Përgjithshme dhe organet e tjera kompetente të drejtimit.

58.10 Kontrolli i librave kontabël bëhet çdo vit nga eksperti(ët) kontabël të autorizuar, i cili (të cilët) emërohen nga Asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### **NENI 59**

#### **RAPORTI VJETOR**

59.1 Raporti vjetor i llogarisë së Shoqërisë do të paraqitet në formën dhe përmbajtjen e caktuar nga dispozitat ligjore në fuqi.

#### **NENI 60**

#### **KREDITË E SHOQËRISË**

60.1 Shoqëria ka të drejtë të marrë kredi në lekë dhe në valutë të huaj si në Bankat Kombëtare Shqiptare, ashtu edhe në banka të tjera vëndase apo të huaja që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të rregullave të përcaktuara nga bankat, të dispozitave të këtij Statuti, si dhe të vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 61**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

61.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis personave të ndryshëm dhe Shoqërisë do të zgjidhen kryesisht mbi bazën e bisedimeve dashamirëse e me mirkuptim me njëri - tjetrin. Në qoftë kjo nuk mund të arrihet, atëherë pala e interesuar mund t'i drejtohet seksionit tregtar të gjykatës kompetente të juridiksionit të vendit (krahinës) ku kanë lindur mosmarrëveshjet, si dhe organeve të tjera ligjore me kompetenca më të larta për mbrojtjen e të drejtave të veta, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

#### **NENI 62**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

62.1 Shoqëria do ketë vulën e saj me përmbajtje: "Shoqëria " AUTO CITY TIRANA" – SH.P.K., Tiranë, Shqipëri".


62.2 Statuti hyn në fuqi qysh nga momenti i nënshkrimit të tij.

62.3 Në rastet e likuidimit perfundimtar të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi, pushon se vepruari edhe ky Statut i saj.


62.4 Ky Statut u printua në shtatë ekzemplarë te barabartë në gjuhën shqipe dhe, pasi u lexua dhe u pëlqye unanimitisht nga ne themeluesit e Shoqërisë "AUTO CITY TIRANA" – SH.P.K., në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, do të nënshkruhet prej nesh në selinë e shoqërisë, ku do të depozitohet ekzemplari i parë.

#### **ORTAKET E SHOQËRISË "AUTO CITY TIRANA" – SH.P.K.**

**Tauland KAMBERI**



**Julian MUJA**



**Ergesti MULLA**

